



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:001216
Datë: 01.10.2020
Numri i dokumentit: 01178678

C.nr.28/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Alban Beqiri, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësve A.S. nga fshati Komuna Ferizaj, Xh.H. nga Ferizaj, Y.S. nga Ferizaj, F.T. nga Ferizaj, B.H. nga fshati Komuna Ferizaj, N.R. nga Ferizaj, R.Q. nga Ferizaj, S.G. nga Ferizaj, S.S. nga Ferizaj, dhe S.Q. nga fshati Komuna Ferizaj të cilët i përfaqëson me autorizim av.Arian Hetemi nga Lipjani kundër të paditurës Komuna Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson me autorizim Sami Vranovci në çështjen juridike pagesa e pagave jubilarë, ushqimit dhe shpenzimet e udhëtimit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 22.09.2020, mori, kurse me datën 01.10.2020, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve A.S. nga fshati Komuna Ferizaj, Xh.H. nga Ferizaj, Y.S. nga Ferizaj, F.T. nga Ferizaj, B.H. nga fshati Komuna Ferizaj, N.R. nga Ferizaj, R.Q. nga Ferizaj, S.G. nga Ferizaj, S.S. nga Ferizaj, dhe S.Q. nga fshati Komuna Ferizaj si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura Komuna Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, që paditësve secilit veç e veç në emër të pagës jubilarë, ushqimit dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit t'ua paguaj shumat dhe atë

- Paditësit A.S. në emër të ushqimit shumën prej 1,096.20€, në emër të udhëtimit shumën prej 383.67€, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 609 ditë apo gjithsejtë shumën prej 1,479.87€ (një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë euro e tetëdhjetë e shtatë cent).

- Paditësit Xh.H. në emër të ushqimit shumën prej 1,096.20€, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 609 ditë, kurse për shpërblim jubilar 50% e një page bazë shumën prej 262.33€, apo gjithsejtë shumën prej 1,358.53€ (një treqind e pesëdhjetë e tetë euro e pesëdhjetë e tre cent).
- Paditëses Y.S. në emër të ushqimit shumën prej 1,096.20€, (një mijë e nëntëdhjetë e gjashtë euro e njëzet cent), për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 609 ditë
- Paditësit F.T. në emër të ushqimit shumën prej 1,096.20€, (një mijë e nëntëdhjetë e gjashtë euro e njëzet cent), për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 609 ditë
- Paditësit B.H. në emër të ushqimit shumën prej 957.60€, në emër të udhëtimit shumën prej 230.20€ për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 532 ditë, apo gjithsejtë shumën prej 1,187.80€, (një mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë euro e tetëdhjetë cent)
- Paditëses N.R. në emër të ushqimit shumën prej 959.40€, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 533 ditë kurse për shpërblim jubilar 50% e një page bazë shumën prej 255.09€, apo gjithsejtë shumën prej 1,214.49€ (një mijë e dyqind e katërbëdhjetë euro e katër dhjetë e nëntë cent).
- Paditësit R.Q. në emër të ushqimit shumën prej 1,096.20€, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 609 ditë kurse për shpërblim jubilar 100% e një page bazë shumën prej 499.82€, apo gjithsejtë shumën prej 1,596.02€ (një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë euro e dy cent).
- Paditëses S.G. në emër të ushqimit shumën prej 1,096.20€, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 609 ditë kurse për shpërblim jubilar 100% e një page bazë shumën prej 528.89€, apo gjithsejtë shumën prej 1,625.09€ (një mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë euro e nëntë cent).
- Paditëses S.S. në emër të ushqimit shumën prej 1,096.20€, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 609 ditë kurse për

shpërblim jubilar 75% e një page bazë shumë prej 404.99€, apo gjithsejtë shumë prej 1,501.19€ (një mijë e pesëqind e një euro e nëntëmbëdhjetë cent).

- Padiësit S.Q. në emër të ushqimit shumë prej 995,40€, në emër të udhëtimit shumë prej 383.67€, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 553 ditë kurse për shpërblim jubilar 75% e një page bazë shumë prej 397.45€, apo gjithsejtë shumë prej 1,776.52€ (një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e pesëdhjetë e dy cent).

III DETYROHET e paditura që shumat e përcaktuara sikurse në pikën II të dispozitivit tua paguaj padiësve secilit veç e veç me kamat ligjore prej 8% nga data 22.09.2020, deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 817.60€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

IV DETYROHEN padiësit që solidarisht të paguajnë diferencën e taksës gjyqësore për padi në shumë prej 60€

A r s y e t i m

Gjykata fillimisht duke u bazuar në propozimin e të paditurës me anë të parashtrësës që ka propozuar që të bëhet bashkimi i padive, në njërën anë, kurse në anën tjetër padiësit përmes të autorizuarit të tyre edhe pse e kanë kundërshtuar këtë propozim gjykata ka kosnideruar se ekzistojnë kushtet ligjore që të bëhet bashkimi i padive dhe atë padia e cila është evidentuar me numër C.nr...../20 si padiës evidentohen N.R. nga Ferizaj, R.Q. nga Ferizaj, S.G. nga Ferizaj, S.S. nga Ferizaj, dhe S.Q. nga fshati Komuna Ferizaj i janë bashkuar padisë me numër C.nr...../20, ku si padiës evidentohen A.S. nga fshati Komuna Ferizaj, Xh.H. nga Ferizaj, Y.S. nga Ferizaj, F.T. nga Ferizaj, B.H. nga fshati Komuna Ferizaj, gjykata në lidhje me këtë propozim ka vendosur me aktvendim procedural në seancën e datës 02.07.2020, kuptim nenit 387 par.1 pika v) e LPK-së.

Padiësit përmes të autorizuarit të tyre kanë deklaruar se mbetësin edhe më tutje në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiës si dhe pranë precizimit të saj, duke shtuar se padiësit janë të punësuar tek e paditura me kontratë të punës në pozitën mësimdhënës në SM Teknike “.....” dhe duke u bazuar në Kontratën Kolektive e paditura sipas nenit 35 par.5.7 dhe 8 ka detyrim që secilit mësimdhënës-padiësve tua paguaj nga 2 euro në ditë, për ditët e prezencës së tyre në

punë në emër të ushqimit, si dhe shpenzimet e udhëtimit e cila e drejtë u takon paditësve në bazë të nenit 35 par. 5 punonjësit ti njihet e drejta e udhëtimit prej 70% bileta e trafikut urban.

Gjithashtu ka theksuar që paditësve u takon edhe paga jubilarë pasi që të njëjtit e kanë përvojën e punës dhe sipas Kontratës Kolektive e paditura ka detyrim që tua paguaj shpërblimin jubilar dhe atë paditësi Xh.H. për shkak të përvojës së punës mbi 10 vite në emër të shpërblimin jubilar prej 50% të pagës bazë shumë prej 262.33€, paditëses N.R. për shkak të përvojës së punës mbi 10 vite në emër të shpërblimin jubilar prej 50% të pagës bazë shumë prej 255.09€, paditësit R.Q. për shkak të përvojës së punës mbi 30 vite në emër të shpërblimin jubilar prej 100% të pagës bazë shumë prej 499.82€, paditëses S.G. për shkak të përvojës së punës mbi 30 vite në emër të shpërblimin jubilar prej 100% të pagës bazë shumë prej 528.89€, paditëses S.S. për shkak të përvojës së punës mbi 20 vite në emër të shpërblimin jubilar prej 75% të pagës bazë shumë prej 404.99€, dhe paditësit S.Q. për shkak të përvojës së punës mbi 20 vite në emër të shpërblimin jubilar prej 75% të pagës bazë shumë prej 397.45€.

Andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që ta aprovon në tërësi kërkesëpadinë e paditësve të precizuar me parashtrësë për secilin veç e veç si të bazuar të gjitha me kamat ligjore prej 8% si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesi i të paditurës ka deklaruar se mbesim edhe më tutje pranë përgjigjes në padi duke kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë të paditësve si të pa bazuar, kurse sa i përket ditët e pranisë në punë, përvojën e punës dhe çmimoren e biletës për udhëtim nuk e ka kontestuar. Ka theksuar se e paditura meqenëse nuk e ka kontestuar asnjëherë ditët e pranisë në punë, lartësinë e çmimit të shujtës ditore dhe çmimit të biletës, ka theksuar se nxjerrja e provës me ekspertizë financiare ka qenë e pa nevojshme pasi që janë krijuar shpenzime të procedurës të panevojshme meqenëse paditësi përmes të autorizuarit të tyre kanë pasur mundësi ti bëjnë përlllogaritjen e lartësisë së kërkesëpadisë pa pasur nevojë nxjerrja e provës me ekspertizës financiare andaj këto shpenzime janë krijuar me fajin e tyre

Sa i përket paditësve N.R. e cila ka përvojë të punës 14 vite, R.Q. me përvojë 35 vite, dhe S.S. e cila ka përvojë të punës 25 vite të drejtën për fitimin e pagave jubilarë e kanë arritur në kohën kur nuk ka qenë në fuqi kontrata kolektive, e cila kontratë me asnjë bazë nuk e ka paraparë efektin retroaktiv.

Andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësve për arsyet e lart cekura.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve ka bërë administrimin e provave si vijojnë: U lexua autorizimet e paditësve A.S. , Xh.H., Y.S., F.T., B.H. dhenë avokatit Arian Hetemi, kontratat e punës të paditësve A.S. ne protokolli/6 dt.01.09.2019, kontrata e punës për Xh.H. nr. protokolli 78/87 dt.01.03.2015, kontrata e punës për Y.S. –L. nr. protokolli 353/7 dt.01.09.2017, kontrata e punës për F.T. nr. portokalli 83/6 dt.02.02.2016, kontrata e punës për B.H. nr protokolli 306/11 dt.05.10.2015, vërtetimet mbi përvojën e punës lëshuar nga SHMT “.....” në emër të paditësve A.S., Xh.H., Y.S.- L., F.T. , B.H., listat e pagës për muajin nëntor 2019 në emër të paditësve A.S., Xh.H., Y.S.- L., F.T. , B.H., autorizimi i të paditurës dhënë Sami Vranofci, vërtetimi lëshuar nga SHMT “..... “ nr protokolli 164 dt.16.06.2020 për ditët e pranisë në punë të paditësve, qmimirja lëshuar nga SHPK dt.21.05.2020, mendimi dhe konstatimi i ekspertit financiar A.K. dt.11.08.2020, autorizimet e paditëvwe N.R.j, R.Q., S.G., S.S. dhe S.Q. dhenë avokatit Arian Hetemi, kontrata e punës për N.R. nr. protokolli /12 dt.03.09.2015, lista e pagës për muajin nëntor 2019 në emër të N.R., kontrata e punës për R.Q. nr. protokolli /3 dt.02.09.2019, lista e pagës për muajin nëntor 2019 në emër t R.Q., kontrata e punës e paditëses S.G. nr prtookolli .../7 dt.01.09.2019, lista e pagës për muajin nëntor 2019 në emër të S.G., kontrata e punës për S.S. nr. protokolli/25 dt.01.03.2015, lista e pagës për muajin nëntor 2019 në emër të S.S., kontrata e punës për S.Q. nr. protokolli /8 dt.03.09.2015, lista e [agës për muajin nëntor 2019 në emër të paditësit S.Q., vërtetimet mbi përvojën e punës lëshuar nga SHMT “.....“ në emër të paditësve N.R.j, R.Q., S.G., S.S. dhe S.Q., autorizimi i të paditurës dhënë Sami Vranfooci

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura në tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk ishte kontestuese në mesë palëve ndërgjygjëse se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe nga data 18.04.2017 kur dhe ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 11.03.2020, kanë qenë në vendin e punës, respektivisht është vërtetuar prezenca e tyre në vendin e punës në ditët e precizuara për secilin paditës veç e veç, por kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë se a u takojnë paditësve shumat e kërkuara.

Gjykata përmes kontratave të punës të cilat janë administruara ka vërtetuar faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura.

Gjykata me leximin e vërtetimeve për ditët në punë dhe përvojën e punët të paditësve lëshuar nga Drejtoria e SHMT “.....”, për secilin paditës veç e veç ka vërtetuar faktin për ditët e pranisë të paditësve në vendin e punës nga data 18.04.2017, kur ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 11.03.2020, dhe atë paditësi A.S. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 609 ditë, paditësi Xh.H. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 609 ditë, paditësja Y.S. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 609 ditë, paditësi F.T. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 609 ditë, paditësi B.H. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 532 ditë, paditësja N.R. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 533 ditë, paditësi R.Q. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 609 ditë, paditësja S.G. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 609 ditë, paditësja S.S. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 609 ditë, dhe paditësi S.Q. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 553 ditë.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësit e kanë shfrytëzuar një të drejtë pasi që të njëjtit përfitojnë nga kjo kontratë për faktin se për periudhën nga data 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, kanë qenë në vendin e punës respektivisht prezenca e tyre në vendin e punës i cili fakt është vërtetuar përmes vërtetimeve për ditët e prezencës së tyre në vendin e punës të lëshuar nga drejtoria e shkollës SHMT “.....”, andaj sipas nenit 35 par.7 është paraparë që të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë, për një ditë pune është 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, andaj gjykata sa i përket aprovimit të lartësisë kërkesëpadsisë në lidhje me ushqimin e ka bazuar duke e llogaritur ditët e pranisë në punë të secilit paditës veç e veç e duke e shumëzuar me 2 euro (bruto), për secilën ditë të pranisë së tyre në vendin e punës, duke zbritur vlerën e tatimit në 10% të vlerës bruto, ka rezultuar shumat e aprovuara sikurse në dispozitiv të aktgjykimit për secilin paditës veç e veç kurse sa i përket aprovimit të lartësisë të kërkesëpadsisë të paditësve A.S., B.H. dhe S.Q. sa i përket

udhëtimet e ka marr për bazë 70%, të biletës urbane, siç është e rregulluar me nenin 35 par.5 i kontratës kolektive e cila dispozitë ligjore e ka rregulluar se punonjësit e arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhet shpenzimet e rrugës 70%, të biletës urbane.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë në lidhje me shpenzimet e udhëtimin gjykata këtë fakt e ka vërtetuar përmes çmimorës të lëshuar nga ekspertiza e ekspertit financiar A.K. e datës 11.08.2020, e cila ekspertizës është bazuar në çmimoren e lëshuar nga sh.p.k e datës 21.05.2020, dhe çmimit të tregut e të cilat për secilin paditës janë të precizuara bileta e udhëtimit ku e paditura nuk e ka kontestuar asnjërit paditësi lartësinë e e çmimit të biletës një drejtimshme pasi që mendimi i ekspertit ka qenë në përputhje me çmimoren e lart cekur të lëshuar nga sh.p.k andaj duke u bazuar në këtë eksperti e ka llogaritur ditët e pranisë në punë, në njërin anë dhe 70% të biletës në ditë në anën tjetër, duke zbritur 10% të tatimit dhe ia ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve sa i përket shpenzimeve të udhëtimit, nga vendbanimi i tyre deri në vendin e punës që e kanë ku paditësi udhëton nga fshati deri në vendin e punës në Ferizaj dhe anasjelltas, paditësi B.H. nga fshati dhe paditësi nga fshati Komuna Ferizaj.

Andaj duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratës Kolektive, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditësve është e bazuar ku dhe e ka detyruar të paditurën që paditësve secilit veç e veç tua paguaj shumat e specifikuar në pikën II të dispozitivit pasi që nga provat e administruara e të cilat nuk kanë qenë kontestuese nga e paditura janë vërtetuar ditët e pranisë në punë për secilin paditës veç e veç nga data 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në njërin anë kurse në anën tjetër e paditura nuk e ka përmbushur obligimin siç e ka pasur për detyrim sipas Kontratës Kolektive e datës 18.04.2017, sa i përket mjeteve monetare për ushqim dhe udhëtim dhe nenit 8 të LMD-së, ku thuhet se “Pjesëmarrësi në marrëdhënie të detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”, e të cilin detyrim e paditura nuk e ka përmbushur ndaj paditësve me arsytim se nuk ka mjete financiare për këtë kategori.

Sa i përket pagës jubilarë gjykata është bazuar në nenin 35 par.8 pika 8.1 dhe 8.2 të Kontratës Kolektive duke u bazuar në listën e përvojës së punës rezulton që paditësi Xh.H. ka përvojë pune 13 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën e që sipas kësaj kontrate për 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 50 % të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditësit bruto është 570.10€, siç vërtetohet përmes ekspertizës financiare e

cila është bazuar në listën e pagave, e që i bije që në emër të pagës jubilarë paditësit i takon shuma prej 262.33€, paditëses N.R. ka përvojë pune 14 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën ku 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 50 % të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga bruto e paditëses është 553.53€, siç vërtetohet përmes listës së pagave i bije që në emër të pagës jubilarë paditëses i takon shuma prej 255,09€, paditësi R.Q., ka përvojë pune 35 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën ku 30 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 100 % të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditësit bruto është 558,62€, siç vërtetohet përmes listës së pagave i bije që në emër të pagës jubilarë paditëses i takon shuma prej 499.82€, paditëses S.G. ka përvojë pune 31 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën ku 30 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 100 % të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditëses bruto është 592.69€, siç vërtetohet listës së pagës i bije që në emër të 100% pagës jubilarë paditëses i takon shuma prej 528.89€, paditësja S.S. ka përvojë pune 25 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën ku 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 75 % të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditëses bruto është 597,69€, siç vërtetohet përmes listës së pagave i bije që në emër të 75% pagës jubilarë paditëses i takon shuma neto prej 404.99€, paditësi S.Q. ka përvojë pune 20 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën ku 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 75% të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditësit bruto është 586,19€, siç vërtetohet përmes listës së pagave i bije që në emër të 75 % pagës jubilarë paditësit i takon shuma neto prej 397,45€.

Sa i pretendimit të përfaqësuesit të paditurës se kërkesëpadia e paditësve duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka mjete financiare që ti përmbushë këto detyrime ndaj paditësve, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate të gjitha DKA e institucioneve të arsimit të lart, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin me kohë për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësit.

Sa i përket pretendimit të paditurës se kemi parashkrim të kërkesëpadisë sa i përket kërkesë në emër të pagës jubilarë për disa paditës dhe atë për paditësen N.R. pasi që e njëjta ka përvojë të punës 14 vite, R.Q. ka përvojë të punës 35 vite kurse paditësja S.S. ka përvojë të punës 25 vite gjykata konsideron se një pretendim i tillë nuk qëndron pasi që Kontrata Kolektive ka hyrë ë

fuqi me datën 18.04.2017, nga e cila periudhë kanë lindur të drejtat dhe detyrimet e të paditurës, andaj dhe nga data 18.04.2017 deri me datën e paraqitjes së padisë në gjykatë 06.01.2020, nuk kanë kaluar 3 vite siç parashihet edhe me nenin 87 të Ligjit të Punës, përveç kësaj edhe me Kontratën Kolektive thuhet se për 10, 20 dhe 30 vite të përvojës së punës, i takon paga jubilarë në përqindje të caktuar çka nënkupton se këtë të drejtë paditësit mund ta kërkojë që në fillimit të mbushjes së përvjetorit jubilar si dhe në vitin e fundit të jubilarit, çka nënkupton se nuk është pengesë dhe në rastin konkretë nuk kemi parashkrim të kërkesë sa i përket pagës jubilarë për paditësit N.R., R.Q. dhe S.S.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata duke u bazuar në nenin 452 par 1 të LPK-së e ka obliguar të paditurën që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 817.60€ dhe atë për përpilim të padisë shumë prej 312€, për taksën gjyqësore për padi 100€, dhe për përfaqësim të avokatit në një seancë 405.60€ për shkak se kemi të bëjmë me mbi 5 paditës si dhe vlera e kontestit është mbi 10.000€, pjesa tjetër refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata me rastin e vendosjes sa i përket shpenzimeve të procedurës i ka marr parasysh vërejtjet e të paditurës pasi që ekspertiza financiare është bazuar pikërisht në çmimoren e biletave të udhëtimit lëshuar nga sh.p.k cila ka qenë pjesë e shkresave të lëndës dhe nuk ka rezultuar ndonjë çmimë tjetër e të provë e paditura asnjëherë nuk e ka kontestuar si dhe nuk e ka kontestuar edhe shumë në emër të ushqimit dhe lartësinë e pagës jubilarë duke marr parasysh përvojën e punës të secilit paditës, kurse sa i përket shpenzime tjera të kërkuara në emër të përfaqësimit në 3 seancave gjykata ia ka njoftuar vetëm shpenzimet për një seancë pasi që i autorizuari i paditësit ka pasur mundësi të bëjë precizimin e kërkesëpadisë për secilin paditës që në seancën përgatitore dhe të lëshohem menjëherë në seancën e shqyrtimit kryesor pasi që nuk ka qenë e ndërlikueshme precizimi i saj, duke marr parasysh të gjitha provat kanë qenë në shkresat e lëndës, andaj dhe shpenzimet tjera të cilat janë krijuar përveç atyre që ua ka njohur gjykata janë krijuar me fajin e të autorizuarit të paditësve, e jo me fajin e të paditurës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.28/20 date 01.10.2020

Gjyqtari
Alban Beqiri

Numri i lëndës: 2020:001216
Datë: 01.10.2020
Numri i dokumentit: 01178678

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.